



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

3662
Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 19.07.2022

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër


Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër **Nr.57**
Datë: 15.07.2022

**“Për një shtesë fondi nga Ministria Arsimit dhe Sportit për investimin “Rikonstrukcion Shkolla 9-
vjecare “Irfan Hajrullai”, Peshkopi”**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.695/1.prot.

Peshkopi, më 25.07.2022

Lënda : Per vendimin nr. 57, datë 15.07.2022 të Këshillit të Bashkis Dibër


Drejtuar : BASHKISE DIBER

PESHKOPI

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.57, date 15.07.2022 "Për një shtesë fondi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për investimin "Rikonstruksion Shkolla 9-vjeçare "Irfan Hajrullai "Peshkopi", vendosa :

Miratimin e vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi dhe zbatimin e tij sipas kushteve tekniko - ligjore të projektit të miratuar, nën përgjegjësinë direkte të struktura të posaçme të Bashkisë të specifikuar në pikën 3 të këtij vendimi.

PREFEKTI
Nexhbedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM
Nr 57 Datë 15/07/2022

“ Për një shtesë fondi nga Ministria Arsimit dhe Sportit për investimin “Rikonstruksion Shkolla 9-vjecare “Irfan Hajrullai”, Peshkopi”.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr.15 datë 25.11.2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.01 datë 13.01.2022, I konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin nr.54/1 datë 21.01.2022,të financuar nga Ministria Arsimit, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 15.07.2022 me 18 vota pro,1 kundër dhe 0 apstenim

VENDOSI:

1. Miratimin e investimit “Rikonstruksion Shkolla 9-vjecare “Irfan Hajrullai”, Peshkopi me vlerë të plotë të projektit në vlerën 57,895,783 (pesëdhjetë e shtatë million e tetëqind e nëntëdhjetë e pesëmijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tre)lekë, Financimi nga MAS për vitin 2022-2023 do të jetë në vlerën 46,316,626 (dyzetë e gjashtëmilion e treqind e gjashtëmbëdhjetë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë)lekë dhe kontributi i Bashkisë Dibër në vlerën 11,579,157 (njëmbëdhjetëmilion e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntëmijë e njëqind e pesëdhjetë e shtatë)lekë.
2. Bazuar në Urdhërin nr.356 datë 22.06.2022, mbi listën me projektet e reja fituese, Thirrja e I për vitin 2022 nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe shkresës nr.3346 datë 30.06.2022 mbi njoftimin për shpallje fitues të projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për objektet shkollore të arsimit parauniversitar dhe programit për sportin.
3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Urbanistikës, Sektori i Prokurimeve Publike dhe Sektori i Financës pranë Bashkisë Dibër.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.



BASHKIA DIBËR
DREJTORIA EKONOMIKE
Sektori i Finances

.....
Adresa: Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi, Albania, nr. tel. & fax. 00355 218 229 37

Relacion shpjegues


KESHILLIT BASHKIAK DIBER

Për miratimin investimit për objektin "Rikonstruksion Shkolla 9-vjecare "Irfan Hajrullai, Njësia Administrative Peshkopi"

Bazuar në shkresën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me nr.4367 prot të datës 28.06.2022 me objekt :njoftim për shpalljen fitues të projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për objekte shkollore të arsimit parauniversitar, me anë të së cilës konfirmohet çelja e fondeve pranë degës së thesarit Diber për financimin e projektit për Rikonstruksion Shkolla 9-vjecare Irfan Hajrullai, Peshkopi me vlerë të plotë të projektit 57.895.783 leke me shtrirje financimi gjatë vitit 2022 dhe 2023, në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54, shkronja k, "miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik" si dhe duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe ligjit nr.15 datë 25.11.2021 "Për buxhetin e vitit 2022", kërkojme miratimin e projekt vendimit për Rikonstruksionin e Shkolles 9-vjecare Irfan Hajrullai Peshkopi në mënyrë që institucioni Bashkia Diber të vazhdojë me nisjen e procedurës së prokurimit për objektin në fjalë.

Drejtor Ekonomik

Mensur SHEHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR
DREJTORIA EKONOMIKE
Sektori i Financës
PROJEKT - VENDIM

Nr. 15 Datë 06/07/2022

“Për një shtesë fondi nga Ministria Arsimit dhe Sportit për investimin “Rikonstrukcion Shkolla 9-vjeçare “Irfan Hajrullai”, Peshkopi

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr.15 datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.01 datë 13.01.2022, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin nr.54/1 prot. datë 21.01.2022, po ju informojmë mbi projektet e financuara nga buxheti i shtetit për projektin e mëposhtëm të financuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit:

Kërkojmë:

- I.** Miratimin e investimit “Rikonstrukcion Shkolla 9-vjeçare “Irfan Hajrullai”, Peshkopi me vlerë të plotë të projektit në vlerën 57,895,783 (pesëdhjetë e shtatë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e pesëmijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tre) lekë, Financimi nga MAS për vitin 2022-2023 do jetë në vlerën 46,316,626 (dyzet e gjashtë milion e treqind e gjashtëmbëdhjetëmijë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë) lekë dhe kontribut i Bashkisë Dibër në vlerën 11,579,157 (njëmbëdhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntëmijë e njëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë.
- II.** Bazuar në Urdhërin nr.356 datë 22.06.2022, mbi listën me projektet e reja fituese, Thirrja e I për vitin 2022 nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe shkresës nr.4367 prot. datë 28.06.2022, e protokolluar nga ana jonë me shkresën nr.3346 datë 30.06.2022 mbi njoftimin për shpallje fitues të projekteve të aplikuar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për objektet shkollore të arsimit parauniversitar dhe programit për sportin.
- III.** Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtorja Urbanistikës, Sektori i Prokurimeve dhe Sektori i Financës pranë Bashkisë Dibër.
- IV.** Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

PËR BASHKINË DIBËR:

Përgjegjëse sektorit Juridik
Elona Lusha

Drejtor i Urbanistikës
Elvis Manga

Përgjegjëse Finance
Erblina Sela

Drejtor Ekonomik
Mensur Shehi

